

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



KOMPENSIME

**TË DREJTAT E
PASAGJERIT,
KOMPANITË
PRANOJNË TË
KOMPENSOJNË 1200
PASAGJERË**
faqe 5

STATISTIKA

NUMRI I PASAGJERËVE

Nga të dhënat zyrtare të për
muajin Nëntor 2018, rezultoi
se ka një rritje krahasuar me
të njëjtën periudhë të 2 viteve
të kaluara. Shifrat tregojnë një
numër prej 201,677 pasagjerë të
cilët kanë udhëtuar gjatë muajit...

faqe 6

TRAJNIME

AAC ZHVILLOHET TRAJNIMI I RADHËS PËR “DG” NGA JAATO

Gjatë muajit Dhjetor në
Autoritetin e Aviacionit Civil në
kuadër të rritjeve të kapaciteteve
teknike të stafit u zhvillua kursi
“Dangerous Goods for CAA
Staff”.

faqe 7



RAPORTI PERFORMANCËS

**VITI 2018, FLY ERNEST KOMPANIA MË PROBLEMATIKE,
NUMËR REKORD VONESASH DHE ANULIME.
72 VONESA, NË SHUMË RASTE MBI 6 ORË DHE 14 ANULIME.
PROBLEM MOS KOMPENSIMI PASAGJERËVE**

EASA: MBAHET TAKIMI VJETOR ME VENDET ANËTARE DHE VËZHGUESE

Në datat 13-14 Dhjetor u mbajt mbledhja e Bordit Drejtues të Agjencisë Europiane për Siguri në Aviacion. Në këtë takim të dytin vjetor dhe të fundit për vitin 2018, morën pjesë drejtorët e gjithë drejtorive të Aviacionit Civil të Bashkimit European dhe të vendeve kandidate të Ballkanit Perëndimor etj., që kanë edhe rolin e vëzhguesit. Takimi i rëndësishëm u fokusua në argumentimin e detajuar që drejtori i EASA-s, Patrick Ky, i bëri gjithë aktivitetit të institucionit që drejton si në aspekte teknike, politike, nismave të reja, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shpenzimeve që janë kryer gjatë vitit 2018. Z. Ky u ndal të firmosja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa agjenci botërore si me Singaporin, etj., si dhe njoftoi hapjen e një zyre të re në Peru, që do të jetë edhe qendra për Amerikën Latine. Një element që ka rëndësi edhe për Shqipërinë, është rregullorja e re e Droneve, dhe masat që Drejtoritë e Aviacioneve Civile europiane do ndërmarrin për ta kontrolluar dhe mos lejuar abuzimet nga përdoruesit. Ky diskutim ishte i rëndësishëm, pasi edhe AAC, është duke hartuar rregullat e reja për dronet. Gjithashtu në këtë mbledhje drejtori i AAC Krislen Keri, diskutoi edhe me homologët e rajonit për të forcuar bashkëpunimin në trajnime dhe konferenca të përbashkëta. Keri u takua edhe me Drejtorin e EASA-s Patrick Ky, me të cilin diskutuan për nismat më të fundit të AAC, si dhe folën për vizitën që Z. Ky ka konfirmuar në Shqipëri në muajin shkurt 2019. I pranishëm në këtë takim të rëndësishëm ishte edhe

drejtori Ekzekutiv i Eurocontrol Eammon Brennan, që u ndal te sfidat që aviacioni civil European ka hasur gjatë



Në foto: gjatë mbledhjes së Bordit të Agjencisë Europiane për Siguri në Aviacionit

këtij viti, që lidhen kryesisht me vonesat e shumta në veçanti gjatë stinës së verës, duke u kthyer në një problem në Europë. Z. Brennan tha se po merren masat që trafiku ajror të devijojë në disa kanale të reja ajrore për të ulur sa më shumë fluksin në disa zona të veçanta të fluturimeve, masë që do të sjellë edhe uljen e konsiderueshme të vonesave për shkak të trafikut ajror.



Në foto: Drejtori i Agjencisë Europiane për Siguri në Aviacionit, z. Patrick Ky



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL


DREJTORI I AAC, KERI: INTERVISTË PËR EMISIONIN “WAKE UP” NË TOP CHANNEL

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, z. Krislen Keri ishte i ftuar në emisionin “Wake Up”, në televizionin Top Channel, ku u diskutua për problemet që hasin pasagjerët shqiptarë, sidomos në periudhat e fundvitit dhe në stinën e verës, të cilat janë edhe periudhat më të ngarkuara të vitit dhe ku regjistrohen edhe më shumë probleme si vonesa apo anulime fluturimesh. Ndër të tjera, Keri jep edhe disa këshilla se si pasagjerët duhet të reagojnë kur hasin problematika si vonesa apo anulime, për të përfituar kompensim deri në 250 eu. Deri më tani janë 700 kompensime, ndërsa numri pritët të rritet pasi një pjesë janë në proces. Keri tha se me emërimin si Drejtor Ekzekutiv ju kushtua një vëmendje e madhe sektorit për të drejtat e pasagjerit, duke sjellë edhe efektet e para pozitive për pasagjerët, që janë kompensuar nga 250 eu rreth 700 pasagjerë deri në muajin dhjetor nga 2000 ankesa që AAC ka administruar. Ai këshilloi të gjithë pasagjerët që udhëtojnë në këtë periudhë që para se të shkojnë në aeroport të kontrollojnë adresat zyrtare të internetit të kompanive dhe të aeroportit, për të parë në kohë nëse ka vonesa ose anulime, të cilat mund të vijnë për shkak të kompanisë apo dhe të kushteve atmosferike për shkak të temperaturave të ulëta ose reshjeve të dëborës. Ndër kompanitë që kanë edhe numrin më të madh të vonesave dhe anulimeve, Keri renditi ato që operojnë me Italinë për shkak edhe se është destinacioni kryesor për pasagjerët shqiptarë. Një shqetësim tjetër për pasagjerët është vonesa e ardhjes së bagazhit, ku Keri sqaroi se edhe në këtë rast parashikohet dëmshpërblim në rast se



Në foto:
Drejtori Ekzekutiv i AAC, z. Krislen Keri gjatë intervistës në emisionin “Wake Up” në Top Channel

dëmtohet ose humbet. Një mënyrë që ua lehtëson njerëzve përzgjedhjen e kompanisë, ai përmendi edhe publikimin e Buletinit mujor, ku paraqitet edhe raporti i performancës për çdo kompani ajrore, duke treguar numrin e plotë të vonesave, anulime apo edhe korrektësinë me kompensimet. Keri theksoi se në 2019, AAC dhe sektori për të Drejtat e Pasagjerit do ti kushtojnë një vëmendje të madhe asistencës dhe informimit të pasagjerëve për të drejtat që ata kanë në raste vonesash apo situata të tjera që mund të hasin para udhëtimit.



RAPORTI PERFORMANCËS:

“FLY ERNEST” KOMPANIA MË PROBLEMATIKE PËR 2018, NUMËR REKORD VONESASH DHE ANULLIME. 72 VONESA, NË SHUMË RASTE MBI 6 ORË DHE 14 ANULLIME.

Viti 2018 në aviacionin civil europian, konsiderohet si ndër më problematikët në dekadën e fundit sa i përket vonesave dhe anulimeve të fluturimeve. Në aeroportet më të mëdha të Europës, sidomos në stinën e verës vonesat tejkaluan normën mesatare duke u kthyer në një problem serioz. Shkakët kryesore, lidhen me mungesën e kapaciteteve, operimit dhe problemeve teknike apo grevat e shumta në veçanti të disa kompanive ajrore. Shqipëria nuk i shpëtoi këtij problemi dhe në veçanti ato linja që operojnë me Italinë. Siç shikohet edhe nga tabela përkatëse kompania më problematike me numrin më të lartë të anulimeve dhe vonesave të fluturimeve është Fly Ernest, e ndjekur nga Blue Panorama, Adria dhe Albwings. Gjithashtu sa i përket orëve të vonesave të gjata mbi 7 orë problematike mbetet kompani Fly Ernest e ndjekur nga Blue Panorama. Nga të dhënat që na vijnë nga përgjegjësjë e Sektorit për të Drejtat e Pasagjerit në AAC, znj. Enkela Hajderi, një aspekt problematik që lidhet me mos respektimin e të drejtave të pasagjerëve është me kompaninë Fly Ernest, e cila ka një numër shumë të ulët të kompensimeve të pasagjerëve. Kompania që respekton më shumë pasagjerët në aspektin e kompensimeve është Blue Panorama me rreth 500 të tilla. Ndërkohë kompanitë më serioze që respektojnë të oraret, janë Turkish Airlines, Austrian Airlines, Alitalia, Lufthansa, British Airways, Aegean. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar po punon ngushtësisht me palën italiane dhe me Komisionin Europian për të rikthyer normalitetin për respektimin e të drejtave të pasagjerëve.




Tabela 1:
Tabela përkatëse për vonesat mbi 2 orë dhe anulimet gjatë vitit 2018

KOMPENSIME


TË DREJTAT E PASAGJERIT, KOMPANITË PRANOJNË TË KOMPENSOJNË 1200 PASAGJËRË, PËRVEÇ 700 QË JANË KOMPENSUAR NDËRKOHË

Një nga prioritetet e Autoritetit të Aviacionit Civil, është respektimi i të drejtave të pasagjerit nga ana e kompanive ajrore. Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga kompanitë ajrore ka patur rritje të numrit të kompensimeve me 250 eu, ndaj pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit. Kompania "Blue Panorama" pavarësisht probleme me vonesat e shumta të rregjistruara në 2018, është kompania e parë sa i përket kompensimit të pasagjerëve me një shifër që shkon në 500 kompensime. Ndërkohë problem mbetet kompania "Fly Ernest", e cila pavarësisht se renditet si kompania më problematike për shkak të vonesave apo anulimit të fluturimeve, ka kryer vetëm 96 të tilla. Në total shifra deri në këtë periudhë ka shkuar në 700 kompensime, nga rreth 2000 formularë të plotësuar. Lajmi pozitiv për pasagjerët është se kompanitë kanë pranuar të kompensojnë 1200 pasagjerë të tjerë dhe kanë filluar procedurat e kompensimit. Që do të thotë se pas plotësimit të dokumentacionit përkatës, pasagjerët që janë prekur nga vonesat apo anulimet do të marrin atë që ju takon më ligj. Kompensim në këto nivele është hera e parë e që zbatohet në aviacionin civil shqiptar në këto 25 vite.


1200

KËRKESA TË PRANUARA

AAC i bën thirrje gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:




www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit



ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN NËNTOR 2018

■ **NËNTOR 2018:** Nga të dhënat zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil për muajin Nëntor 2018, rezulton se ka një rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të 2 viteve të kaluara. Shifrat tregojnë një numër prej **201,677** pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Nëntor për/nga TIA. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet zotërimi i tregut të transportit ajror nga secila kompani, në përqindje për muajin Nëntor 2018. Bazuar në të dhënat e mëposhtme, kompania ajrore “Blue Panorama” është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Nëntor 2018, me 24% të totalit. Ndjekur nga Ernest S.p.A me 14% ndaj totalit dhe 29 mijë pasagjerë dhe duke vijuar me dy kompanitë “AlbaWings” dhe “Alitalia” secila me 10% ndaj totalit.




■ **PËRQINDJET:** Përqindjen më të madhe të tregut në transportin ajror për muajin Nëntor 2018 vazhdon ta zotërojë Italia, duke zënë 58% të totalit, ndjekur nga Turqia, me 10% dhe Austria me 6%. Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve, ka një rritje prej 8% gjatë nëntorit të 2018.

ANALIZA STATISTIKORE

PËR MUAJIN NËNTOR 2018

■ **NUMRI I PASAGJERËVE** Shifrat paraqesin një numër prej 201,677 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Nëntor 2018 për/ nga TIA. Tabela e mëposhtme jep një informacion të plotë krahasimor për muajin Nëntor të tre viteve të fundit të numrit të pasagjerëve sipas shoqërive ajrore.



Grafiku 2:
Grafiku paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve të muajit Nëntor 2018 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2016 dhe 2017

TRANSPORTI CARGO

MUAJI NËNTOR

Për sa i përket transportit të ngarkesës Cargo gjatë muajit Nëntor 2018 ka një rritje prej 11% kundrejt Nëntorit 2017 dhe Nëntori i vitit 2017 ka pasur ngritje prej 7% krahasuar me muajin Nëntor 2016.

Statistika më të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

CARGO NËNTOR 2016-2017-2018									
	Nëntor 2016			Nëntor 2017			Nëntor 2018		
	Mallra (kg)	Posta (kg)	Cargo (kg)	Mallra (kg)	Posta (kg)	Cargo (kg)	Mallra (kg)	Posta (kg)	Cargo (kg)
	138,411	37,297	175,708	147,300	42,898	188,468	164,325	44,178	208,323
TOTAL	139,787	37,297	175,708	147,300	42,898	188,468	164,325	44,178	208,323

Tabela përkatëse

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT DHJETOR

AAC, ZHVILLOHET TRAJNIMI PËR "MALLRAT E RREZIKSHËM"

Gjatë muajit Dhjetor në Autoritetin e Aviacionit Civil në kuadër të rritjeve të kapaciteteve teknike të stafit u zhvillua kursi "Dangerous Goods for CAA Staff". Ky kurs theksoi rëndësinë e filozofisë së parrezikshmërisë dhe u ndal te transporti i mallrave të rrezikshëm në aviacionin civil ku u ndalën në filozofinë e përgjithshme të transportit të këtyre lloj mallrave duke i dhënë rëndësi kompetencave dhe përgjegjësi që Autoritetet kanë si dhe

aplikimet praktike të Aneksit 18 , rasteve urgjente, njoftimeve shtetërore etj. Në këtë kurs morën pjesë inspektorë teknik të Drejtorisë së Aeroporteve dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes. Në këtë kurs ishin të pranishëm 10 pjesëmarrës.



Në Foto:
gjatë trajnimit që u zhvillua në Tiranë pranë zyrave të AAC nga JAA TO

TIRANË-ZHVILLOHET TRAJNIMI I ICAO-S PËR "STANDET DHE PRAKTIKAT E REKOMANDUARA"

Gjatë datave 10-14 Dhjetor në Tiranë u zhvillua kursi i ICAO-s me mbështetjen vullnetare të Qeverisë së Kinës për të rritur kompetencat e personelit për nivelin e mesëm dhe të lartë të drejtuesve për sa i përket menaxhimit të përputhshmërisë me Standardet dhe Praktikave të Rekomanduara të ICAO-s. Në këtë kurs kishte pjesëmarrje të lartë nga vende si Azerbajxhani, zyra rajonale e ICAO-s në Paris, Mali i Zi, Moldavia. Ekspertëve të huaj ju bashkua dhe stafi i AAC-së, Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve si dhe përfaqësues nga Aeroporti Nënë Tereza. Ky kurs intensiv kishte për qëllim aftësimin e drejtuesve për të planifikuar,

menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë të vazhdueshme implementimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të ICAO-s.



Në Foto:
pjesëmarrësit gjatë trajnimit që u zhvillua në Tiranë nga ICAO.

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT DHJETOR

WORKSHOP "CORSIA"

Në datat 13-14 Dhjetor morën pjesë pikat e kontaktit të nismës CORSIA (Carbon Offsetting and Reduction Scheme for International Aviation) në workshopin e organizuar në Turqi nga ECAC me mbështetjen e Agjencisë Gjermane të Mjedisit dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Turqisë. Workshop-i u zhvillua në Akademinë e Aviacionit Civil të Turqisë me pjesëmarrje

nga Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Moldavia, Serbia, Republika e Maqedonisë dhe Turqia. Ky workshop ishte vetëm faza e parë për ngritjen e kapaciteteve në secilin prej shteteve, bazuar në Standartet dhe Praktikat e Rekomanduara (SARPs) të Aneksit 16 të ICAOs, në të cilin paraqiten hapat që duhet të plotësojnë operatorët ajror dhe shtetet për implementimin e CORSIA-s.



Në Foto:

gjatë workshop-it që u zhvillua në Akademinë e Aviacionit Civil të Turqisë

TAKIMI I 50-TË PC/CN TË KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM DHE TË PËRHERSHËM NË EUROCONTROL

Shqipëria nëpërmjet AAC është një anëtare aktive e Eurocontrol dhe e institucioneve ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil. Në datën 29 Nëntor 2018 u zhvillua takimi i radhës së Provisional Council/PC (Komisionit të Përkohshëm) të Eurocontrol.

Komisioni i Përhershëm, me rekomandimin e Komisionit të Përkohshëm mori vendimet e mëposhtme:

1. Miratoi buxhetin e vitit 2019.
2. Mori vendimin e zgjeruar nr. 153 të CN lidhur me përcaktimin e tarifave të njësisë për periudhën e aplikimit duke filluar më 1 janar 2019;
3. Mori Vendimin e zgjeruar CN Nr. 154 lidhur me normën e interesit për pagesat e vonuara të tarifave të rrugës për periudhën e aplikimit duke filluar nga 1 janari 2019

4. Komisioni i Përhershëm, me rekomandim të Këshillit të Përkohshëm, i dha Agjencisë Direktivën Nr. 18/105 në lidhje me pranimin e emërimit nga Komisioni Evropian i EUROCONTROL si Menaxher i Rrjetit për funksionet e rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror (ATM) të Qiellit të Vetëm Evropian.
5. Komisioni i Përhershëm, me rekomandim të Këshillit të Përkohshëm, mori Vendimin e Komisionit të Përhershëm nr. 132, duke deklaruar Komisionin e Rregullimit të Sigurisë (SRC) të fjetur (pasiv) dhe ranë dakord të mbajnë në shqyrtim nevojat pan-evropiane në diskutimet e mëtejshme midis EASA dhe Agjencinë.
6. Komisioni i Përhershëm vuri në dukje se, në përputhje me Nenin 2 të Rregullores së Punës së CN, Republika e Armenisë do të marrë Presidencën dhe Zëvendës Presidencën për Komisionin e Përhershëm për vitin 2019.



AUDITI VJETOR NË ALBCONTROL

Siguria e Transportit Ajror është në fokusin e përhershëm të aktivitete të Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës (AKM). Për këtë qëllim, bazuar në Udhëzimin Nr. 118, datë 23.10.2012, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, "Për Miratimin e Rregullores për Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe në Shërbimet e Lundrimit Ajror", nëpërmjet Drejtorisë së Mbikëqyrjes të Shërbimeve të Navigimit Ajror pranë Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), përgatiten programe auditime periodike me teknikën e "risk-based oversight". Auditimi i plotë i radhës në Ofruesin e Shërbimeve Navigacionale, Albcontrol sh.a. u krye nga AAC/AKM në Dhjetor të 2018.

Më konkretisht, gjatë auditit u verifikuan funksionet për shërbimet në fushën e:

- (a) Kontrollit të Trafikut Ajror,
- (b) Informacionit Aeronautik,
- (c) Shërbimet Meteorologjike dhe ato të,
- (d) Komunikimit, navigimit dhe mbikqyrjes.

Në vijim u verifikuan përmbushja e kërkesave të licencimit të Kontrollorëve ajrorë, funksionet e sigurisë (Safety) dhe ndjekja e rekomandimeve dhe gjetjeve të mëparshme dhe Verifikimi i UNC-ve. Në përmbledhje të situatës për gjithë shërbimet e ANSP mund të themi në përgjithësi se janë bazuar në procedura dhe standarde sipas rregullave të mirëcaktuara si dhe karakterizohet nga përpjekje të vazhdueshme për ti përmirësuar dhe zhvilluar më tej.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL



Aviacioni në Botë



EUROCONTROL Eurocontrol dhe NATO bien dakord që të punojnë ngushtësisht për të përballuar sfidat në aviacionin civil dhe atë ushtarak. Gjatë një takimi drejtori i Eurocontrol Eamonn Brennan zhvilloi me Asistent Sekretarin e NATOS për Mbrojtjen dhe Investimet Camille Grand, rakorduan që të punojnë më shumë për të zgjeruar efikasitetin e fluturimeve, kapacitetet e hapësirës ajrore dhe rritur efektivitetin e misionëve ushtarakë. Një nga pikat më të rëndësishme ishte përballimi me sukses i sfidës të rritjes së trafikut ajror civil në mënyrë që të ulet edhe numri i vonësive që krijoi një problem të madh në Europë gjatë stinës së verës. Ndërsa në aspektin ushtarak të krijohet hapësira e nevojshme për



kërkesat e reja të ushtrisë për futjen në përdorim të avionëve të rinj të gjeneratës së 5-të që do të futen së shpejti në përdorim në hapësirën ajrore Europiane. Dy zyrtarët e lartë duke u bazuar edhe në memorandumet e bashkëpunimit të firmosura në 2004 dhe në 2014, thanë se është shumë e rëndësishme që të ketë bashkëpunim mes NATO-s dhe Eurocontrol për të përballuar sfidat e të ardhmes.

LONDËRALARM NGA DRONET MBYLLET DISA ORË AEROPORTI "HEATHROW" 140 mijë pasagjerë u detyruan të prisnin për 1 ditë në Aeroportin e Heathrow në Londër, për shkak të



mbylljes së papritur dhe anulimit të qindra fluturimeve. Shkak u bë zbulimi i dy droneve pranë njëres nga pistat e fluturimit duke shkaktuar alarm për sigurinë. Ngjarja e regjistruar në datën 20 dhjetor, ka detyruar aksionerët e aeroportit, që të investojnë miliona paund në teknologjinë antidronë, duke kërkuar dhe asistencën e ushtrisë. Nga hetimet për këtë ngjarje rezultoi se nuk kishte qëllime terroriste për ndërprerjen e fluturimeve për atë ditë. Kompanitë ajrore siguruan pasagjerët e afektuar se do të kompensohen për shqetësimin. Por kjo ngjarje e bën edhe më emergjente krijimin e ligjeve të posaçme për përdoruesit e droneve

SHBA AEROPORTI BROSHURA INFORMUESE PËR PËRDORUESIT E DRONEVE

Dronet janë kthyer në një problem të madh për Aeroportet, pasi çenojnë hapësirën ajrore dhe janë rrezik për aksidente. Pas situatës së ndodhur në Aeroportin e Heathrow në Londër, ndër më të mëdhenjtë në Botë, që u mbyll për disa orë për shkak të evidentimit të droneve,



në SHBA drejtuesit e Aeroportit të Winskoin kanë shpërndarë broshura informuese me rregullat që përdoruesit duhet të dinë, kur blejnë një dron. Drejtori i Aeroportit tha se përdoruesit duhet të dinë që nuk mund të fluturosh një dron poshtë 5 kg mbi 300 metra, ndërsa distanca nga aeroporti duhet të jetë të paktën 7 kilometra. Sipas tij për kategoritë mbi këtë peshë, duhet një leje e posaçme kontrolli. Problem mbetet se shumë njerëz nuk e kanë informacionin e duhur dhe kjo bën që në shumë raste të shkaktojnë alarm, pasi nëse futen në hapësirën ajrore të aeroportit pikasen menjëherë.